



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

---

Numri i lëndës: 2019:222666  
Datë: 21.03.2025  
Numri i dokumentit: 07024300

Ac.nr.4158/2022

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Halide Reka, kryetare e kolegjit, Nora Bllaca Dula dhe Naime Ahmeti anëtar, në çështjen juridike kontestimore të paditësit I.M nga Prishtina, rruga “V.G”, B-\*, H-\*/\*\*, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Jeton Osmani, avokat nga Prishtina, kundër të paditurës Koorporata Energjetike e Kosovës-KEK SH.A, me seli në Prishtinë, rruga “N.”, nr. \*\*, për kompensimin e pagave në emër të shpërblimit jubilar, duke vendosur sipas ankesës së paditësit, të paraqitur kundër Aktvendimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, C.nr.\*\*\*\*/19, të datës 10.05.2022, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 18.03.2025, mori këtë:

**A K T V E N D I M**

REFUZOHET si e bazuar ankesa e paditësit I.M nga Prishtina, rruga “V.G”, B-\*, H-\*/\*\*, ndërsa Aktvendimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, C.nr.\*\*\*\*/19, i datës 10.05.2022 VËRTETOHET.

**A r s y e t i m**

Gjykata e shkallës së parë, me aktvendimin e ankimuar C.nr.\*\*\*\*/19, të datës 10.05.2022, e ka hedhë poshtë si të palejueshëm revizionin e paditësit I.M nga Prishtina, të paraqitur kundër Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës në Prishtinë, Ac.nr.\*\*\*/21, të datës 28.01.2022.

Kundër këtij aktvendimi paditësi në afat ligjor nëpërmes përfaqësuesit të autorizuar ka ushtruar ankesë duke e atakuar të njëjtin për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave procedurale dhe vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, me propozim që gjykata e shkallës së dytë

ta aprovojë ankesën si të bazuar, aktvendimin e atakuar ta prishë dhe në kuptim të nenit 219 të LPK-së lënda ti dërgohet Gjykatës Supreme për vendosje.

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktvendimin e atakuar, në mbështetje të dispozitës së nenit 194, 208 dhe 209 të Ligjit të Procedurës Kontestimore (LPK), ka gjetur se:

*Ankesa e paditësit është e pabazuar.*

Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësi I.M nga Prishtina, përmes të autorizuarit të tij, me datë 18.06.2019 ka paraqitur padi kundër të paditurës Korporata Energjetike e Kosovës Sh.A, me seli në Prishtinë, lidhur me kompensimin e pagave në emër të shpërblimit jubilar. Në padi ndër të tjera ka theksuar se paditësi ka qenë në marrëdhënie pune tek e paditura në vendin e punës Manipulant i Demiralizimit, me përvojë pune mbi 40 vite, ku për realizimin e pagave jubilarë paraprakisht i është drejtuar të paditurës, mirëpo e njëjta ia ka refuzuar kërkesën, duke vepruar kështu në kundërshtim me Marrëveshjet e Përgjithshme Kolektive të Kosovës (MPKK). Në petitutim të padisë ka kërkuar që të detyrohet e paditura që paditësit në emër të tri pagave jubilarë t'ia paguaj shumën e tërësishme prej 2,872.32 euro, me kamatë ligjore prej 8 % nga dita e paraqitjes së kërkesës me datë 30.05.2019 e gjer në pagesën definitive, si dhe të paguaj të gjitha shpenzimet e procedurës deri në përfundimin e kontestit, e të gjitha këto në afat prej 7 ditësh nga dita kur aktgjykimi të merr formën e prerë nën kërcënim të përmbarimit me dhunë.

Gjykata e shkallës së parë duke vepruar sipas paditësi së paditësit, ka mbajtur shqyrtimin kryesor të çështjes, ku pas shqyrtimit dhe administrimit të provave të propozuara nga palët ndërgjyqëse, si dhe shqyrtimit të të gjitha shkresave tjera të lëndës ka marrë Aktgjykimin C.nr.\*\*\*\*/19, të datës 02.11.2020, me të cilin e ka refuzuar në tërësi si të pabazuar kërkesëpadinë e paditësit, duke vendosur më decidivisht si në dispozitiv të atij aktgjykimi.

Gjykata e Apelit të Kosovës në Prishtinë duke vendosur sipas ankesës së paditësit me Aktgjykimin Ac.nr.\*\*\*/2021, të datës 28.01.2022, e ka vërtetuar Aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë, C.nr.\*\*\*\*/19, të datës 02.11.2020, ndërsa ankesën e paditësit e ka refuzuar si të pabazuar.

Paditësi përmes të autorizuarit të tij me datë 16.03.2022, ka paraqitur revizion kundër Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës në Prishtinë, \*\*\*/2021, të datës 28.01.2022, me propozimin që Gjykata Supreme e Kosovës ta aprovojë revizionin e paditësit si të bazuar, ashtu që të anulohet Aktgjykimin e Gjykatës së Apelit Ac.nr.\*\*\*/21 të datës 28.01.2022, apo që Gjykata Supreme e Kosovës ta ndryshoj Aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë, C.nr.\*\*\*\*/19, i datës 02.11.2020, duke e aprovuar kërkesëpadinë e paditësit si të bazuar.

Gjykata e shkallës së parë duke vlerësuar lejueshmërinë e revizionit të paraqitur nga paditësi I.M nga Prishtina, bazuar në dispozitën e nenit 211 paragrafi 3 lidhur me nenin 218 të LPK-së, e ka hedhë poshtë revizionin e paditësit si të palejuar.

Në arsyetim të aktvendimit të atakuar, gjykata e shkallës së parë ka theksuar se revizioni nuk lejohet në kontestet pasurore-juridike në të cilat kërkesëpapia nuk ka të bëjë me kërkesat në para, me dorëzimin e sendit apo me përmbushjen e ndonjë premtimi tjetër, po që se vlera e objektit të kontestit e treguar në padinë e paditësit nuk e kalon shumë prej 3.000 Euro, andaj revizioni i paditësit është dashtë të hedhet poshtë nga fakti se vlera e kontestit të padisë dhe kërkesëpadi së lëndore nuk është mbi vlerën 3.000 Euro dhe po ashtu natyra e kontestit nuk përbën përjashtimin për lejueshmërinë e revizionit, prandaj në këtë rast për shkak të vlerës së kontestit, revizioni është i palejuar.

Konstatimet faktike dhe vlerësimin juridik të gjykatës së shkallës së parë rreth mënyrës së vendosjes sipas aktvendimit të goditur, si të rregullt dhe të bazuar në ligj e pranon edhe Gjykata e Apelit e Kosovës, për shkak se aktvendimi i ankimuar nuk është përfshirë me shkelje të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika b), g), j), k), dhe m) të LPK-së dhe drejtë është zbatuar e drejta materiale për të cilat gjykata e ankimit kujdeset çdoherë sipas detyrës zyrtare në kuptim të nenit 194 të LPK. I njëjti aktvendim po ashtu del të mos jetë përfshirë as me shkelje procedurale sipas pretendimeve ankimore të palës ankuese.

Duke iu referuar pretendimeve ankimore të paditësit, Gjykatës së Apelit i ka rezultuar se gjykata e shkallës së parë me aktvendimin e atakuar drejtë ka vendosur kur ka hedhur poshtë si të palejuar revizionin e paditësit të paraqitur kundër Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit Ac.nr.\*/2021, të datës 28.01.2022, kjo duke vlerësuar lejueshmërinë e revizionit në kuptim të dispozitave të nenit 211 paragrafi 3 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, në të cilën është përcaktuar se: *“Revizioni nuk lejohet në kontestet pasurore-juridike në të cilat kërkesëpapia nuk ka të bëjë me kërkesat në para, me dorëzimin e sendit apo me përmbushjen e ndonjë premtimi tjetër, po që se vlera e objektit të kontestit e treguar në padinë e paditësit nuk e kalon shumë prej 3.000 Euro”*. Në rastin konkret bëhet fjalë për një padi, vlera e së cilës është përcaktuar në padinë e datës 18.06.2019, konkretisht në petitumin e padisë në shumë prej 2,872.31 Euro, e cila vlerë nuk është ndryshuar gjatë gjithë procedurës së zhvilluar në këtë çështje juridike kontestimore, në anën tjetër në shkresat e lëndës gjendet edhe dëftesa për pagesën e taksës gjyqësore në shumë prej 20 Euro, nga të cilat rezulton se revizioni i paditësit në kuptim të dispozitës së lartcekur ligjore është i palejuar. Ndërsa në bazë të nenit 218 të LPK-së, i ndryshuar me Ligjin 04/L-118, përcaktohet se: *“Revizioni i paraqitur pas kohe, i palejueshëm apo jo i plotë, hedhet poshtë me aktvendim të gjykatës së shkallës së parë pa mbajtur seancë gjyqësore”*, andaj mbi bazën e të lartcekurave kolegji i kësaj gjykate pajtohet plotësisht me përfundimin e gjykatës së shkallës së parë, se revizioni i paditësit në këtë çështje juridike kontestimore në kuptim të dispozitave ligjore të lartpërmendura është i palejuar.

Gjykata e Apelit me rastin e vendosjes i vlerësoi edhe të gjitha pretendimet tjera ankimore, mirëpo të njëjtat pretendime nuk ishin me ndikim për një vendim ndryshe për çka edhe vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Numri i lëndës: 2019:222666  
Datë: 21.03.2025  
Numri i dokumentit: 07024300

Nga arsyet e cekura Gjykata e Apelit, vendosi sikurse në dispozitiv të këtij aktvendimi në mbështetje të dispozitave nga neni 194, 208 lidhur me nenin 209 pika b) të LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË  
Ac.nr.4158 /2022, me datë 18.03.2025.

Kryetarja e kolegjit,  
Halide Reka d.v